
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“A-TECH” SHPK**

THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA

**Neni 1
Ortakët themelues**

Sot më datë 30.07.2018 Ortakët themelues të shoqërisë:

1. **Z. Gentjan Filaj**, i biri i Haxhiut, lindur me 13.07.1970 në Fier dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. BA3016672, lëshuar nga Ministria e Brendshme dt.22.12.2010.
2. **Z. Klodjan Bidaj**, i biri i Flamurit, lindur me 23.02.1989 dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet ID me nr. I90223055G, lëshuar nga Ministria e Brendshme dt.16.06.2009.
3. **Z. Hasan Hodaj**, i biri i Tekiut, lindur me 04.07.1963 në Damës dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet ID me nr. G30704150W lëshuar nga Ministria e Brendshme dt.08.02.2017.

Hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“A-TECH” sh.p.k.**, mbështetur ne ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”(ndryshuar), ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (ndryshuar), dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar, si me poshte:

**Neni 2
Forma Ligjore e Shoqërisë**

- 2.1 Shoqëria **“A-TECH” sh.p.k** është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte referuar “Shoqëria”).
- 2.2 Shoqëria **“A-TECH” sh.p.k** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortakët e shoqërisë”, të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributiet e ortakeve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
- 2.3 Ortaket gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

Neni 3
Kohëzgjatja e Veprimtarisë

- 3.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 4
Selia/Adresa e Regjistruar

- 4.1 Selia e Shoqërisë është: Tirane, Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Sami Frasheri, Ndertesa Nr. 19, Hyrja Nr. 8, Kodi Postar 1019.
- 4.2 Administratori mund të krijojë NIPT-e sekondare të Shoqërisë.

Neni 5
Objekti

- 5.1 Objekti kryesor i Shoqërisë është:

- Investime dhe pjesëmarrje ne investime me shoqeri te tjera shqiptare dhe te huaja ne fusha te ndryshme si: industri,ndertim,bujqesi,transport,hoteleri, turizem etj. Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore, ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime/germime dhe sistemime dheu, tarracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndertime rruges, asfaltime, hapje kanalesh si dhe cdo ndertim tjetër me karakter civil dhe ekonomik, ndertime ne zona turistike, hoteleri, restorante, sherbime te ndryshme. Projektim dhe ndertim termocentrale, hidrocentrale, vepra hidrike, stacione, nenstacione elektrike, prodhim, shitje energji elektrike.
- Shitblerje me shumice e pakice dhe eksport import i mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, materiale te ndertimit, lende te para, gjysem fabrikate, makineri paisje makineri dhe pjese ndertimi per to.
- Si dhe cdo veprimtari tjetër ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 6
Kapitali

- 6.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) Lek.
- 6.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 3 pjesë (kuota), 1 pjesë (kuotë) me vlerë nominale 51.000 (pesedhjetë e një mijë) Lek, 1 pjesë (kuotë) me vlerë nominale 25.000 (njëzet e pesë mijë) Lek dhe 1 pjesë (kuotë) me vlerë nominale 24.000 (njëzet e katër mijë) Lek.

6.3 Kuotat do të mbahen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:

- a. **Z. Gentjan Filaj**, zotëron 51 % të kapitalit të Shoqërisë;
- b. **Z. Klodjan Bidaj**, zotëron 25 % të kapitalit të Shoqërisë;
- c. **Z. Hasan Hodaj**, zotëron 24 % të kapitalit të Shoqërisë;

STRUKTURA DREJTUESE

Neni 7

Asambleja e Ortakëve

- 7.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.
- 7.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve (“**Asambleja e Ortakëve**”), të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruar nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.
- 7.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendos për çështjet e mëposhtme:
- a. modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
 - b. të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;
 - c. të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
 - d. vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
 - e. të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
 - f. të miratojë raportet vjetore dhe bilanci dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
 - g. të depozitojë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
 - h. të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë;
 - i. të shkrijë Shoqërinë;
 - j. të vendosë pagën e Administratorit;
 - k. të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - l. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
 - m. të vendosë mbi buxhetin vjetor;
 - n. të vendosë marrjen e huave apo dhënieve të garancive nga Shoqëria;
 - o. të vendosë për çdo çështje tjetër, që i takon për zgjidhje asamblesë së ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.

Neni 8
Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

- 8.1 Vendimet, të listuar më sipër, në lidhje me ndryshimin e këtij Statuti, caktimin e pagës së administratorëve, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit (në përputhje me nenin 20 të Statutit), marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria, organizimin dhe shpërndarjen e Shoqërisë kërkojnë një shumicë të cilësuar prej 75 % të ortakëve prezentë ose të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuorumit të parashikuara në Nenin 15 më poshtë ("**Shumicë e Cilësuar**"). Të gjitha vendimet e tjera të Asamblesë së Ortakëve mund të miratohen me shumicë të thjeshtë të ortakëve prezent apo të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuorumit në Nenin 15 më poshtë ("**Shumicë e Thjeshtë**"). Përfundimisht, vendimet e Asamblesë së Ortakëve për caktimin e administratorit miratohen me Shumicë të Cilësuar. Nëse Asambleja e Ortakëve nuk arrin të sigurojë shumicën e nevojshme për caktimin e Administratorit/ëve me Shumicë të Cilësuar për dy herë radhazi, atëherë Administratori/ët i/e Shoqërisë do të caktohen me Shumicë të Thjeshtë.

Neni 9
Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve

- 9.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.
- 9.2 Asambleja e përgjithshme thirret nga Administratori edhe nëse,
- a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c. Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 9.3 Më tej, anëtarët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme të Shoqërisë mund t'i kërkojnë administratorit me shkrim apo me postë elektronike thirrjen e asamblesë së ortakëve. Kërkesa duhet të mbajë arsyet dhe objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e ortakëve duhet të vendosë.


-
- 9.4 Asambleja e Ortakëve do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga administratori, i cili duhet t'u dërgohet përfaqësuesve të ortakëve me letër rekomande ose faks ose postë elektronike (e-mail) jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara ditës së caktuar për asamblenë. Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t'u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.
- 9.5 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligji të Shoqërive Tregtare.

Neni 10 **Administrimi i Shoqërisë**

- 10.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm.
- 10.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.
- 10.3 Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.
- 10.4 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 10.5 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - c. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
 - d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - e. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
 - f. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
 - g. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori

- mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
- i. administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
 - j. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
 - k. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
 - l. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim Asamblesë së Ortakëve;
 - m. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
 - n. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
 - o. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - p. cdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.
- 10.6 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumice të Thjeshtë.
- 10.7 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat **5 vjeçar**:


Zj. Ermira PEPAJ, shtetase shqiptare, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur më 19-07-1986, në Fier dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e ID me nr. personal I65719106K, me speciment nënshkrimi _____



Neni 11

Viti Financiar dhe Dividendi

- 11.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.



-
- 11.2 Pas përcaktimit të fitimit të Shoqërisë në përputhje me pasqyrat financiare dhe pas përmbushjes së kërkesave së nenit 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, fitimi i Shoqërisë, deri sa të shlyhet shumata e investimit fillestar, ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së tyre në shoqëri.

Neni 12
Mosmarrëveshjet


Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 13
Dispozita perfundimtare


- 13.1 Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplare me përmbajtje **A-TECH** dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nën per nen nga Ortaket e shoqërisë tregtare "**A-TECH**" sh.p.k nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "A-TECH" sh.p.k.

Z. Gentjan Filaj



Z. Klodjan Bidaj



Z. Hasan Hodaj

